



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Gjilanit**  
**Opština Gnjilane**  
**Municipality of Gjilan**  
**Gilan Belediyesi**

## **R R E G U L L O R E N**

**PËR**

**TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2013**

Gjilan, janar 2013

Në bazë të nenit 12.1 dhe 12.2 pika c) nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenit 2.3 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 27/2008) nenit 39 paragrafi 1.3, 97 dhe 102 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të dt. 11.11.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 30.01.2013, miraton:

**RREGULLOREN  
PËR  
TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2013**

Dispozitat e përgjithshme:

Qëllimi

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e taksave, ngarkesave dhe gjobave për shërbime publike komunale, nevoja tjera për persona fizik dhe juridik që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe jetësor në territorin e Komunës së Gjilanit.

Lartësia e taksave dhe ngarkesave

Neni 2

Lartësia e taksave dhe ngarkesave që do të paguajnë qytetarët, personat fizik dhe juridik, në emër të shërbimeve komunale që ju ofrohen ,do të caktohen sipas drejtorive përkatëse.

Neni 3

3.1. Taksat/tarifat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

N/r	Shërbimet ( dokumenti)	Lartësia e taksës €
1.1	Lëshimi i certifikatës të lindjes, martesës, vdekjes dhe statusit martesor	1.00
1.2	Procedura-ceremonia e kurorëzimit	10.00
1.3	Kurorëzimi jashtë orarit të punës	20.00
1.4	Kurorëzimi jashtë orarit të punës dhe jashtë selisë së organit	30.00
1.5	Lëshimi i certifikatës mbi Vendbanimin	2.00
1.6	Përpilimi dhe lëshimi i Aktvdekjeve	3.00
1.7	Lëshimi i certifikatës që personi është gjallë- në jetë	2.00
1.8	Lëshimi i certifikatës mbi gjendjen familjare	2.00
1.9	Lëshimi i certifikatës mbi shtetësinë	2.00
1.10	Lëshimi i certifikatës mbi identitetin	3.00
1.11	Lëshimi i certifikatës mbi vendqëndrimin	2.00
1.12	Vërtetim që personi i caktuar nuk-është banor i Komunës së Gjilanit	2.00
1.13	Vërtetim mbi varshmërinë materiale nga personi i caktuar	2.00
1.14	Përpilimi dhe lëshimi i deklaratës së dëshmitarit	2.00

1.15	Vendimi mbi regjistrimet e mëvonshme në LAL, LAM dhe LAV	3.00
1.16	Vendimi mbi ndryshimet e mëvonshme në LAL, LAM dhe LAV	10.00
1.17	Vendimi mbi korrigjimet e mëvonshme në LAL, LAM dhe LAV	3.00
1.18	Ankesa kundër vendimit të organit të shkallës së parë	Pa pagesë
1.19	Lëshimi i vërtetimit mbi shpenzimet e varrimit	Pa pagesë
1.20	Vërtetim identik me origjinalin (1-3 faqe)	1.00
1.21	Vërtetim identik me origjinalin (mbi tri faqe)	3.00
1.22	Vërtetim për lajmërimin ose ç`lajmërimin e vendbanimit	2.00
1.23	Shërbimet jashtë selisë së organit (sigurimi i transportit-automjetit)	10.00
1.24	Gjetja – sigurimi i dokumenteve në arkivin e drejtorisë	2.00
1.25	Lëshimi i akteve me foto vetëm për nevoja të brendshme	3.00
1.26	Vërtetime, certifikata të ndryshme të palëve, që nuk janë të përfshira më lartë	3.00
1.27	Kërkesa për fitimin e shtetësisë	5.00
1.28	Kërkesë për lirim nga shtetësia	10.00
1.29	Lëshimi i vërtetimit mbi kapacitetin martesor	2.00
1.30	Fotokopjimi i dokumenteve për nevojat e qytetarëve, për një faqe	0.05
1.31	Ri-regjistrimet në LAL, LAV dhe LAM sipas vendimit të organit kompetent dhe sipas dokumentacionit të posaçëm (edhe nga bota e jashtme).	2.00

3.2. Nga pagesa për shërbimet e kryera për tarifrat 1.1 – 1.31 në bazë të paragrafit 3.1 të këtij neni lirohen:

- a) shfrytëzuesit e ndihmës sociale, pensionistët e vendit (Kosovës), Invalidët e luftës dhe anëtarët e familjet e tyre të ngushta, veteranët e luftës dhe familjet e tyre te ngushta, anëtarët e familjes së ngushtë të viktimave të luftës, të burgosurit politik dhe personat me aftësi të kufizuara,
- b) nxënësit për regjistrimin e vitit shkollor,
- c) studentët e komunës së Gjilanit për regjistrimin në vitin shkollor akademik dhe për semestër”
- d) lirimi nga pagesa e taksës komunale nën a, b dhe c do të bëhet pasi që pala – kërkuesi ta paraqes dëshminë mbi statusin përkatës.  
përfshirë për lirim nga tarifrat 1.1-1.31 të paragrafit 3.1 bëjnë tarifrat: 1.3, 1.4, 1.11, 1.16 dhe 1.21.

3.3. Përveç lirimeve të parapara në paragrafin 3.2 nga tarifa 1.18 lirohen të gjithë taksa paguesit.

3.4. Kërkesat zyrtare për të gjitha shërbimet lirohen.

3.5. Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Gjilanit, apo drejtpërsëdrejti te zyrtari i autorizuar, i cili obligohet që palës t’i jep dëshmi mbi pagesën e bërë.

3.6. Qyqaret lirohen nga pagesa e shërbimeve për përmirësime në dokument zyrtar, në rast se përmirësimi i dokumentit kërkohet të bëhet për shkak gabimit të zyrtarit i cili ka lëshuar dokumentin zyrtar.

## Neni 4

### 4.1 Taksat/tarifat, ngarkesat për ushtrimin e veprimtarisë afariste:

N/r	Veprimtaritë/afariste	Lartësia e taksës €
2.1	Kompanitë publike regjionale (Hidromorava, Eco-Higjiena)	600.00
2.2	Kompanitë publike nacionale (KEK-u, Telekom, Vala)	1500.00
2.3	Kompanitë e sigurimeve - filialet	800.00
2.4	Operatorët e Sigurimeve	500.00
2.5	Kontrollimet Teknike	500.00
2.6	Bankat ekspoziturat - filialet	800.00
2.7	Pikat e bankave brenda territorit të komunës	400.00
2.8	Institucionet Mikrofinanciare (Kredi-dhënie, KEP, FINCA etj.)	500.00
2.9	Këmbimoret	200.00
2.10	Agjencitë e transferit të parave	150.00
2.11	Hipermarketet dhe supermarketet me shtrirje nacionale	1000.00
2.12	Kompanitë e telefonisë mobile, rrjetit të internetit dhe TV kabllorike ( Ipko, Z mobile, Kujtesa etj.)	1000.00
2.13	Bingot, bastoret, lotaritë dhe lojërat tjera të fatit	1000.00
2.14	Kazino	1500.00

4.2 Tarifat dhe ngarkesat prej 2.1 – 2.14 sipas nenit 4.1 të kësaj rregulloreje, mund të paguhesh në 2 këste (kësti i parë deri më 30 qershor, kurse kësti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit përkatës).

4.3 Bizneset nga pika 2.11 deri në 2.14 paguajnë 60% për njësit e tyre dhe pikat e shitjes brenda territorit të komunës.

Neni 5

5.1. Taksat/tarifat për Shërbime Publike

N/r	Shërbimet/aktivitetet	Lartësia e taksës €
3.1	Pranimi i kërkesave	5.00
<b>Zhvendosja – bllokimi dhe vendqëndrimi i automjeteve të konfiskuara</b>		
3.2	Për zhvendosjen e motoçikletës, traktorit, pa mjet bashkëngjitesh ose të veturës, brenda qytetit deri në autopark për vendosje dhe ruajtje deri në njëzet e katër (24) orë, shuma e shpenzimeve është tridhjetë (30) euro ku 50% të shpenzimeve paguhen për kompaninë shërbyese dhe 50% për komunën.	30.00
3.3	a) Tërheqja e mjetit transportues rimorkio ose gjysmë rimorkio, autobusit brenda qytetit deri në autopark dhe ruajtja deri në njëzet e katër (24) orë.	100.00
	b) sjellja e mjeteve me mjet bashkëngjitesh në autopark nga vet pronari me asistimin e policisë, pronari paguan vetëm për ruajtje dhe qëndrim të mëtejshëm të mjetit në autopark, për një ditë qëndrimi dhe ruajtje do të paguan shumën prej:	5.00
<b>Zhvendosja e mjeteve</b>		
3.4	a) pa ngarkesë për një km,	0,25
	b) me ngarkesë për një km,	0,50
3.5	Për zhbllokimin e mjeteve, autobusëve, mjeteve transportuese, mjeteve të punës dhe rimorkiot, duhet të paguhet.	15:00
3.6	Në rast kur zhvendosja e mjetit vetëm fillon , por nuk është bërë zhvendosja deri në- vendin e ruajtjes, zbatohen çmimet si vijon:	
	a) në zonë urbane 15 euro	
	b) ndërsa jashtë zonës urbane zbatohet tarifa 3.4 pika a) dhe b).	
	c) Nga tarifat për shërbimet e ofruara 50% paguhen për kompaninë shërbyese dhe 50% për komunën.	
3.7	Kur mjeti i zhvendosur pas kalimit të kohës prej njëzet e katër (24) orëve, nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi pas kësaj kohe, për çdo 24 orë do të paguhet për vendqëndrim, në autoparkun e Komunës.	5.00
3.8	Kur mjeti i bllokuar, pas kalimit të kohës prej njëzet e katër (24) orëve, nga pronari ose shfrytëzuesi i mjetit nuk përmbush detyrimet, për një ditë qëndrimi dhe ruajtje do të paguaj çmimin.	5.00
<b>Lejet për ndërhyrje në infrastrukturë dhe hapësirë tjetër publike</b>		
3.9	a) leja për prerjen e asfaltit në rrugë dhe trotuare 1m <sup>2</sup>	50.00
	b) leja për prerjen e rrugëve dhe trotuareve të pa asfaltuara, parqeve, kubave të betonit, beton etj për 1m <sup>2</sup>	25.00
	c) leja për ndërhyrje në infrastrukturë pa prerje të asfaltit (me shpim)	5.00
<b>Procesi mbi plotësimin e kushteve teknike për auto – taksi (leje pune-kartela)</b>		
3.10	a) për 5 (4+1) ulëse,	10.00
	b) për kamionët e lehtë deri 3.5 T, traktorë,	20.00
	c) për kamion, autobus, minibus dhe mjete tjera të rënda	30.00
Tarifat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike sipas zonave të qytetit për m <sup>2</sup> . Vendosja e tezgave lëvizëse dhe objekteve tjera të vogla, të përkohshme – sezonale, lëvizëse në të cilat kryhet veprimtaria		

(tregti, hotelieri) si dhe pajisjeve të caktuara teknike ( gjeneratorë, bankomat) - tarifa mujore.		
3.11	a) zona I për m <sup>2</sup> b) zona II për m <sup>2</sup>	10.00 8.00
Vendosja e mjeteve për akullore, aparat kafe dhe mjete tjera të ngjashme – tarifa mujore.		
3.12	a) zona I për aparat b) zona II për aparat	10.00 8.00
Vendosja e tezgës së hapur dhe lëvizëse për shitjen e librave - tarifa mujore.		
3.13	a) zona I b) zona II	10.00 5.00
Shfrytëzimi i hapësirës publike (para, pranë dhe për rreth objektit) në të cilën kryhen shërbime hoteliere – tarifa mujore.		
3.14	a) zona I për m <sup>2</sup> b) zona II për m <sup>2</sup>	5.00 4.00
Ekspozimi i pllakateve (panove) reklamuese në hapësira publike, tarifa vjetore për m <sup>2</sup>		
3.15	a) zona urbane b) zona jashtë urbane	40.00 30.00
3.16	Pllakatet (pakot) reklamuese me ndriçim, paguhen me tarifë të shtuar	40%
3.17	Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese	90.00
3.18	Vendosja e reklamave (muraleve) në fasada – muret e ndërtesave për m <sup>2</sup>	50.00
3.19	Nëse shfrytëzimi reklamues bëhet më pak së 30 ditë shtohet vlera për	100%
3.20	Nëse pllakati është shumë krahësh, paguhet për çdo krah të dukshëm.	
3.21	Nëse pllakati është i vendosur në pronë private (të vetën), por për objektiv ka reklamimin, pala paguan sipas tarifave 3.16-3.20 me zbritje.	50%
3.22	a) ekspozimi i reklamave në automjete, autobus, minibus, tarifa vjetore b) ekspozimi i reklamave në automjete me 5 (4 + 1) ulëse, tarifa vjetore.	20.00 20.00
3.23	Për shfrytëzime tjera të hapësirës publike- ekspozimi (reklamimi) për 1 m <sup>2</sup> – tarifa ditore (deri 5 ditë).	5.00
Tarifat për organizimin e lojërave argëtuese, të fatit dhe lojërave argëtuese automatike të ndryshme, si dhe rekuizitave tjera sportive.		
3.24	Vendosja e aparateve për lojëra fati, lojëra argëtuese etj. Tarifa mujore për çdo aparat sipas llojit	10.00
3.25	Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e objekteve argëtuese (parqeve argëtuese). Tarifa mujore për m <sup>2</sup>	0.50
3.26	Leja për vendosjen e materialit ndërtimor, druve, thëngjilli etj. Në hapësirat publike për 24 orë	15.00
Leje për bllokim të rrugës (shiritit rrugor – trotuarit)		
3.27	zona e I-rë - 12 orë zona e I-të - 24 orë	30 40
3.28	zona e II-rë – 12 orë zona e II-të - 24 orë	15 25
3.39	Leja për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në trotuar, në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni, për 1 muaj.	20.00
3.30	Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt dhe për transport të veçantë – Operatori transportues paguan taksën për një vit për 1km.	0.50
3.31	Leje për një (1) hyrje në qytet të automjetit transportues për mallra komerciale (tregtare) mbi 3.5 ton në terminin e kohës: a) për sezonin verorë nga ora 10:00 deri ora 20 dhe	15.00

	b) për sezonin dimërorë nga ora 11:00 deri ora 18:00.	
Leje për hyrje ditore në qytet, për një kamion për transportimin e materialit (largimi i dheut, betonit dhe materialit tjetër ndërtimor)		
3.32	a) për një hyrje b) për dy hyrje c) për tri hyrje d) për katër hyrje e) për pesë e më tepër hyrje	20.00 16.00 12.00 10.00 8.00
3.33	Pëlqimi për plotësimin e kushteve teknike për vend-parkimin e automjeteve transportuese për mallra dhe udhëtar (Autoparku).	40.00
Parkingjet në hapësirat publike - tarifat		
3.34	a) në parkingjet e rezervuara të Komunës – mujore b) parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektivë për persona fizik – mujore c) parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektivë për persona juridik – mujore d) parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektivë- për persona fizik - vjetore e) parkingjet e rezervuara të komunës rreth objekteve të banimit kolektivë për persona juridik – vjetore	30.00 10.00 20.00 100.00 200.00
Parkingjet publike një shiritore		
3.35	Në parkingjet publike me shirita të ndarë në rrugë, trotuar – tarifa mujore a) për persona fizik b) për pësona juridik	20.00 30.00
3.36	Parkingu kohor për 1orë a) në parkingjet e Komunës b) në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona I c) në parkingjet publike në shirita të ndara të rrugëve – zona II	0.50 0.30 0.20
Qiraja për vendosjen e transmetuesve (anteneve), me frekuenca të ndryshme dhe objekteve tjera të ngjashme, për nevoja të telefonisë mobile, fikse, televizionit, internetit e tjera të ngjashme, paguhet tarifa vjetore (nga vlera e llogaritur e objektit):		
3.37	a) zona urbane b) zona rurale	800.00 500.00
Pëlqim për rregullimin e trotuarit		
3.38	Lëshimi i pëlqimit para objektit të banimit, lokalit dhe pëlqimet tjera: a) për persona fizik b) për persona juridik	10.00 15.00
Pëlqim për plotësimin e kushteve teknike të objekteve për qasje në rrugë publike		
3.39	a) lëshimi i pëlqimit për kyçje – qasje në infrastrukturën rrugore pa shirita qarkullues përcjellës. b) lëshimi i pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për kyçje-qasje në infrastrukturën rrugore, me shirita qarkullues përcjellës – për çdo kyçje – qasje.	150.00 300.00

Taksa për Automjetet Motorike		
3.40	a) për automjetet deri 125 ccm b) për automjetet nga 125 ccm deri në 3500 ccm c) për automjetet dhe taksi – automjete mbi 3500 ccm	5.00 10.00 20.00
Shfrytëzimi i mineraleve (lënda minerale) materiale të palidhura dhe inert		
3.41	a) për rërë dhe zhavorr – aluvione për m <sup>3</sup> duhet paguar b) për rërë dhe zhavorr në lum për m <sup>3</sup> duhet paguar	1.25 1.25
Për shërbime tjera		
3.42	Pëlqim për zhvarrosjen (ekshumacionin e kufomave), dhe mbetjeve të kufomës.	30.00
3.43	Vendosja e foltoreve telefonike – tarifa mujore	10.00
3.44	Shtrirja e rrjetit kabllor (ajror) të internetit, për metër gjatësi	1.00
3.45	Vendosja e ormanëve shpërndarëse MDF, për copë – tarif mujore	15.00
3.46	Gropimi i tokës urbane, rrugëve, trotuareve, hapësirave tjera publike për ndërtimin e kanalizimit kabllor energjetik, telekomunikacionit, fibrit – kablllo optik sipas nivelit të tensionit dhe me dimensione të ndryshme, duhet paguar për metër gjatësi:	3.00
3.47	Oferta për shitblerjen e banesës.	5.00
3.48	Vërtetimi për dëmet e shkaktuara nga lufta e tërmeti etj	Lirim
Qiraja për shfrytëzim të pronës komunale		
3.49	Të gjitha objektet komunale me material të fortë ndërtimor me destinim lokal afarist- qira mujore për m <sup>2</sup> . 1. zona A/I 2. zona A/II 3. zona A/III	15.00 8.00 4.00
3.50	Bodrumet të cilat shfrytëzohen si lokale afariste – qiraja mujore për m <sup>2</sup>	1.80
3.51	Depo për ngrohje qendrore – qiraja mujore për m <sup>2</sup> .	1.10
3.52	a) objektet e përkohshme komunale (kiosqet, barakat) – qiraja mujore për m <sup>2</sup> . b) objektet e përkohshme të vendosura në pronë komunale (kiosqet, barakat e të ngjashme) – qiraja mujore për m <sup>2</sup> .	10.00 4.00
3.53	Objektet komunale, të cilat shfrytëzohen për ushtrimin e veprimtarive zejtare (këpucëtar, kapelapunues e të ngjashme), qiraja mujore për m <sup>2</sup> .	10.00

5.2. Nga pagesa e tarifës dhe ngarkesa 3.1 të kësaj rregulloreje lirohen:

- pala dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta (babai, nëna, bashkëshorti-ja dhe fëmijët) që marrin ndihmë sociale nga qendra për punë sociale në Gjilan,
- personat me aftësi të kufizuar, familjarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve, personat të cilët kanë statusin e invalidit të punës, të luftës dhe personat – shoqatat dhe institucionet qeveritare e jo qeveritare,
- iniciativat qytetare – kërkesat për projekte të infrastrukturës publike,
- kompanitë publike, me rastin e kërimit të lejes për ndërhyrje në infrastrukturë, për mirëmbajtje të rrjeteve të tyre (ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefonik etj.) dhe



- e) organizatat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare dhe  
 f) nxënësit dhe studentet për marrjen e vërtetimeve, referencave e të ngjashme.
- 5.3. Lirimi nga tarifat dhe ngarkesat sipas paragrafit 5.2 të kësaj rregulloreje, vërtetohet me dëshmi përkatëse të cilën e ofron kërkuesi i shërbimit.
- 5.4. Nga pagesa e tarifës 3.23 lirohen, institucionet publike, bashkësitë fetare, shoqatat që i reklamojnë/eksponojnë prodhimet e veta vendore sipas rekomandimeve të drejtorisë së bujqësisë dhe drejtorisë për zhvillim ekonomik, si dhe shoqatat dhe organizatat që organizojnë manifestime për qëllime humanitare, kulturore, sportive dhe argëtuese.
- 5.5. Nga pagesa e tarifës dhe ngarkesës 3.29 dhe 3.34 lirohen automjetet të cilat përdoren për transportimin e personave me aftësi të kufizuara (me sjelljen e dëshmisë) dhe automjetet zyrtare të institucioneve publike.
- 5.6. Nga pagesat e tarifave 3.9, 3.27 dhe 3.28 lirohen kompanitë të cilat i realizojnë projektet e kontraktuara me komunën gjatë ndërhyrjes në infrastrukturën publike si dhe ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë shërbime publike (KEK-u, PTK, Hidromorava, Ecohigjiena, Kosovatrans dhe shërbimet emergjente).
- 5.7. Nga pagesa e tarifave 3.2-3.5 dhe 3.7-3.8 lirohen mjetet e zhvendosura ose mjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e policisë, me qëllim të verifikimit të dokumentacionit dhe të mjetit, kur verifikimi rezulton i rregullt, ndërsa gjykata duhet të përcaktojë se kush duhet t'i bartë shpenzimet e vendqëndrimit sipas këtyre tarifave.
- 5.8. Nga pagesa e tarifave 3.2-3.5 dhe 3.7 lirohen mjetet e zhvendosura ose që tërhiqen në rast kur mjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në mjet.
- 5.9. Nga pagesat e tarifave 3.2-3.5 lirohen automjetet e tërhequra nga policia për shkaqe sigurie (tubime, manifestime, realizim projektesh, lirim të hapësirës për intervenime emergjente, etj.)
- 5.10. Nga pagesa e tarifës 3.7 – 3.8 lirohet pronari i automjetit të vjedhur, pra pronari paguan vetëm shpenzimet e tërheqjes sipas tarifave: 3.2- 3.5 kurse shpenzimet sipas tarifës 3.7 – 3.8 gjykata duhet t'ia ngarkoj kryesisht të veprës.
- 5.11. Nga pagesa e tarifës 3.40 lirohen automjetet të cilat përdoren:
1. nga shërbimi i emergjencës (të ndihmës së parë, zjarrfikësit);
  2. për transportimin e personave me aftësi të kufizuara (me sjelljen e dëshmisë), për qëllime tjera domethënëse shoqërore ose publike (automjetet zyrtare të Komunës).
  3. nga invalidët e UÇK-së, anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së dhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme të historisë, me sjelljen e dëshmisë.
- 5.12. Për të gjitha objektet e ndërtuara me material të fortë në pronë komunale e të cilat komuna i trajton si uzurpime, shfrytëzues i paligjshëm i tyre do të ngarkohet me gjobë 100% e çmimit bazë të tarifës 3.49 të paragrafit 5.1 të kësaj rregulloreje. Kjo do të vlejë për kohën derisa komunës nuk i duhen këto hapësira për nevoja të saja zhvillimore.  
 Personi që posedon leje për ndërhyrje në infrastrukturë sipas tarifës 3.9, do të mbikëqyret sipas
- 5.13. detyrës zyrtare nga një komision i përbashkët i emëruar nga DSHP-ja dhe Inspeksioni.

5.14. Bizneset prodhuese në komunën e Gjilanit të dëshmuara, kanë zbritje 50% nga tarifa 3.18.

#### Neni 6

6.1. Taksat/tarifat në sferën e Urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit

N/r	Shërbimet/aktivitetet, tarifat/ngarkesat dhe gjobat	Vlera €				
4.1	Kërkesa për Ekstrakt nga Plani Urbanistik / PZHK-PZHU-PRrU-PDU/	10.00				
4.2	Kërkesa për ndarje – bashkim të 1. parcelë	10.00				
4.3	Për çdo parcelë tjetër	3.00				
4.4	Kërkesa për kushte të lokacionit-pëlqim urbanistik- mjedisor	10.00				
4.5	Kërkesa për Ndryshim-Plotësim-Ndërrim destinim të Planit	10.00				
4.6	Kërkesa për kushtet e ndërtimit	10.00				
4.7	Kërkesa për Leje Ndërtimi /të gjitha llojet e ndërtimit/	10.00				
4.8	Kërkesa për Vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së KN-LN	10.00				
4.9	Kërkesa Leje paraprake në vend punishte	10.00				
4.10	Kërkesa për Leje Rrënimi – Demolimi - Largimi të objektit	10.00				
4.11	Kërkesa për Kontrollim Teknik- certifikatë Përdorimi të objektit	10.00				
4.12	Kërkesa për ndërrim destinimi të shfrytëzimit të objektit	10.00				
4.13	Kërkesa për Komisione të ndryshme	10.00				
4.14	Kërkesa për lëshimin e vërtetimeve, certifikatave, dokumenteve etj.	10.00				
Kategorizimit i objekteve sipas destinimit- përmbajtjeve, zonave dhe çmimi i kompensimit të rregullimit për 1m <sup>2</sup> të bruto sipërfaqes/hapësirës						
Destinimi		A – Zona Urbane			B- Zona Rurale	
		Zona A/I	Zona A/II	Zona A/III	Zona B/ I	Zona B/ II
4.16	BANIMI: (objekte-shtëpi për banim familjar më sipërfaqe maksimum deri në 450m <sup>2</sup> , vikend shtëpizat, garazhet, kuzhinë verore, depot e druve, etj në kuadër të truallit ndërtimor)	8.00	7.00	6.00	4.00	3.00
4.17	AFARIZMI: (objekte afariste, tregtare, hoteliere, shërbyese, arsimore, edukative, agjenci turistike, garazha - parkingje publike, tregje e të ngjashme	15.00	12.00	10.00	7.00	5.00
4.18	OBJEKTET PRODHUESE –PËRPUNUESE: punëtoritë prodhuese- përpunuese, zejtare, e të ngjashme.	8.00	7.00	6.000	2.00	1.00
4.19	OBJEKTET BUJQËSORE: stallë, fermë, e të ngjashme	/	/	/	3.00	2.00
4.20	OBJEKTET-TERENET REKREATIVE-SPORTIVE: fushat e sportit dhe rekreacionit, pishina, objekte rekreative sportive, lojërash dhe të ngjashme	5.00	4.00	3.00	2.00	1.00

4.21	OBJEKTE EKSPLOATIMI TE RESURSEVE NATYRORE: objekte për eksploatimin e resurseve natyrore (gurit, zhavorri, erës, ujit, etj )	/	/	3.00	2.00	1.00
4.2 2	OBJEKTE TE KARBURANTEVE-GASIT:	80.00	60.00	40.00	20.00	10.00
4.2 3	OBJEKTE TË INFRASTRUKTURËS TEKNIKE KOMUNALE: rrjet të elektroenergjisë, PTK , gazsjellësit, përçuesve tjerë të ngjashme	2/m Gjatësi	2/m gjatësi	2/m gjatësi	1.5/ m gjatësi	1.5/ m gjatësi
4.2 4	OBJEKTE MONTUESE / të karakterit të përkohshëm (kioske, baraka, garazha, tenda, etj )	15.00	12.00	6.00	3.00	2.000
4.2 5	OBJEKTE LEVIZËSE / tavolina shitëse, reklamuese, mobile, ambulatorë, bankomate, frigoriferë, etj.	20.000	15.00	10.00	7.00	5.00
4.2 6	Reklama- pano, e të ngjashme:	20.00	15.00	10.00	5.00	3.00

6.2. Shuma e kompensimit sipas tarifave 4.16 deri në 4.26, varësisht nga lloji i sipërfaqes - hapësirës llogaritet si vijon:

1. mbyllur: 100%;
2. mbuluar: 50% dhe
3. hapur: 20%,
4. suterani: 75%,
5. bodrumi: 50% nga shuma e paraparë në pasqyrën tabelës së mësipërme.

6.3. Kompensimi i komisioneve:

- a) kompensimi për organin mbikëqyrës të punimeve në objekte është 1% të vlerës investive të objekteve;
- b) kompensimi i komisionit për kontrollim teknik në objekte është 1% të vlerës investive të objekteve.

6.4 a) pagesa për rregullimin e tokës ndërtimore bëhet përnjëherë, para lëshimit të vendimit-lejes përkatëse.

- b) në rast se lartësia e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore tejkalon shumën mbi 15.000,00€, pagesa mund të paguhet edhe në këste;
- c) kësti i I-rë caktohet në shumë prej 30% nga paralogjaria totale;
- d) lartësia e kësteve të mbetura mbulohet me garancion bankar dhe pagesa e shumës së mbetur prej 70%, paguhet në 6 këste të barabarta në çdo 2 muaj nga dita e pagesës së 30%.

6.5 Përjashtim- nga obligimi për pagesën për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore bëjnë:

- a) objektet investuese të cilat janë: institucionet shtetërore të Kosovës, Institucionet Komunale dhe organet tjera, themeluese e të cilave është Komuna e Gjilanit;
- b) objektet e karakterit të përgjithshëm shtetëror dhe publik;
- c) objektet e infrastrukturës publike teknike komunale;
- d) objektet e mbrojtjes shëndetësore, sociale, të arsimit, shkencës, kulturës, artit, rekreacionit

- dhe sportit;
- e) objektet e ndërtuara nga donacionet;
  - f) personat-investuesit, të cilët bëjnë rehabilitimin, adaptimin dhe renovimin e brendshëm, gëlqerosjen-ngjyrosjen e jashtme dhe përfundimin-ndërrimin e tjegullave të çatisë, në kuadër të gabaritit dhe etazhitetit të objektit ekzistues të ndërtuar legalisht dhe pa ndërrim të destinimit;
  - g) personat të cilët janë të pajisur paraprakisht me leje ndërtimi për hapësirën për të cilën dëshmon në formë të shkruar, se objekti është-ka qenë i i pajisur me leje ndërtimi;
  - h) objektet fetare, nëse objektet e tilla nuk shërbejnë për afarizëm dhe përfitim;
- 6.6 Në rrugën e cila ndan dy zona, ose nëse objekti i cili është në këndin e rrugës të cilat i përkasin dy zonave të ndryshme, lartësia e kompensimit, caktohet sipas zonës në të cilën lartësia e kompensimit është më e lartë.
- 6.7 Investuesit të cilët kërkojnë ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të objektit-hapësirës, obligohen që të paguajnë diferencën në mes destimit paraprak dhe destinimit të cilin e kërkon, nëse lartësia e kompensimit është më e lartë.
- 6.8 Në rast të tejkalimit të gabaritit dhe etazhitetit, nga leja, investuesi gjohet në vlerën prej 200% nga shuma bazë, nëse lejojnë kushtet urbanistike-teknike dhe hapësinore.
- 6.9 Pala dhe anëtarët e familjeve të tyre të ngushta (babai, nëna, bashkëshorti-ja dhe fëmijët) që marrin ndihmë sociale, personat me aftësi të kufizuar, familjarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe personat të cilët kanë statusin e invalidit të punës dhe të luftës, lirohen nga tarifat 4.1 – 4.14 të nenit 6 paragrafi 1.

#### Neni 7

##### 7.1. Taksat/tarifat në sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësorë:

N/r	Shërbimet/aktivitetet	Lartësia e taksës €
Shërbimet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH)		
5.1.	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratike ose pa procedura plotësuese diagnostiko me aparaturë	1.00
5.2.	Ekzaminimi specialistik në QMF dhe QKMF me udhëzim të mjekut familjar	2.00
5.3.	Ekzaminimi specialistik në QMF QKMF pa udhëzim të mjekut të familjes	4.00
5.4	Ekzaminimi në shtëpi përpos në rastet emergjente	6.00
5.5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatore publike (për recetë)	0.30
5.6.	Ultrazëri standard	2.00
5.7	Radiografia	2.00
5.8	EKG	0.50
5.9	Analizat laboratorike – vetëm hemogrami dhe urina	1.00
5.10	Analizat laboratorike (komplet)	3.00
5.11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	1.00
5.12	Audio gram	1.00
5.13	Shpërlaja e veshit	1.00

5.14	Dhënia e injeksionit intermuskular në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
5.15	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në raste emergjente	1.00
5.16	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrim deri në shërim të plagës ( vetëm në vizitën e parë)	3.00
5.17	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
5.18	Certifikata e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi profesionist	18.00
5.19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	18.00
5.20	Dhënia e raportit mjekësor – vërtetimit ose dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	5.00
Shërbimet stomatologjike në nivelin e QMF-së		Lartësia e taksës €
5.21	Vizita e parë stomatologjike	1.00
5.22	Rtg i dhëmbit	1.50
5.23	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00
5.24	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00
5.25	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	5.00
5.26	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	6.00
5.27	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	6.00
5.28	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme(amalgamë ose kompozitë)	6.00
5.29	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë ose kompozitë)	6.00
